



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

MANUALI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 693 Prot.

Tiranë, më 12.06.2026

V E N D I M

Nr. 110 Datë 12.06 2026

P Ë R

MIRATIMIN E MANUALIT TË “ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE”

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; në zbatim të kërkesave të Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t (IFPP); si dhe të Qëllimit Strategjik nr. 2, “Rritja e ndikimit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve”, të Planit Strategjik të KLSH-së 2023-2027, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 247, datë 29.12.2022, si dhe në Urdhrin nr. 7, datë 10.01.2024, të Kryetarit të KLSH-së “Për përditësimin e Manualit të Zbatimit të Rekomandimeve në KLSH dhe Regjistri Elektronik Institucional”,

V E N D O S A:

1. Miratimin e Manualit të Zbatimit të Rekomandimeve, bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Ngarkohen Departamentet e Auditimit, Departamenti i Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve, Sektori i Statistikave për zbatimin e këtij Manuali.
3. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit Profesional, për përfshirjen në planin e trajnimeve dhe organizimin e veprimtarisë trajnuese për njohjen e gjithë stafit auditues me këtë Manual.
4. Vendimi Nr.67, datë 23.06.2020 për miratimin e Manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të KLSH-së dhe Regjistri Elektronik Institucional” shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Arben Shehu



TABELA E PËRMBAJTJES

01	Hyrje	5
02	TË PËRGJITHSHME	7
	2.1 Qëllimi i Manualit	7
	2.2 Baza Ligjore	8
	2.3 Përkufizime	13
03	PROCESI I NDJEKJES SË REKOMANDIMEVE	14
	3.1 Pranueshmëria e Rekomandimeve (Vetëdeklarimi 20 – ditor i Subjektit)	18
	3.1.1 Statusi i Pranueshmërisë së Rekomandimeve	19
	3.2 Zbatueshmëria e Rekomandimeve	20
	3.2.1 Procesi i Verifikimi të Zbatimit të Rekomandimeve Nëpërmjet Vetëdeklarimit 6 – Mujor	25
	3.2.2 Procesi i Verifikimi të Zbatimit të Rekomandimeve në Auditimet e Radhës, si Drejtim i Veçantë në Programin e Auditimit	26
	3.2.3 Procesi i Verifikimi të Zbatimit të Rekomandimeve si Auditim me Program të Dedikuar (Tematik)	28
04	RAPORTIMI	32
05	MONITORIMI DHE PËRMIRËSIMI I VAZHDUESHËM	37
06	KUFIZIME	39
07	ANEKSE	41
	ANEKS 1: Projekt-raporti dhe Raporti Përfundimtar i Zbatimit të Rekomandimeve (auditim tematik)	42
	ANEKS 2: Regjistri i zbatimit të rekomandimeve	43
	ANEKS 3: Evidencat e zbatimit të rekomandimeve	54
	ANEKS 4: Raporti i Konsoliduar i Zbatimit të Rekomandimeve, në nivel institucional	56

1.Hyrja

Në përmbushje të detyrimeve të tij kushtetuese dhe ligjore, si dhe me qëllim informimin e Kuvendit dhe të opinionit publik, Kontrolli i Lartë i Shtetit, përmes veprimtarisë audituese, synon të sigurojë menaxhimin e fondeve publike me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë, nëpërmjet adresimit të rekomandimeve me ndikim përmirësues dhe korrigjues. Në këtë kuadër, KLSH angazhohet të monitorojë zbatimin e këtyre rekomandimeve, duke u mbështetur në parimet, metodologjitë dhe procedurat e miratuara në Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t (IFPP), si dhe në praktikat më të mira të Institucioneve Supreme të Auditimit të komunitetit INTOSAI.

Rikthimi i vëmendjes së Institucioneve Supreme të Auditimit drejt konsolidimit të mekanizmave dhe politikave efektive për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve është tashmë një trend global brenda komunitetit INTOSAI. Në këtë kontekst, ky manual vjen si një mjet praktik dhe mbështetës për audituesit e KLSH-së, duke ofruar udhëzime konkrete për zbatimin efektiv të procesit të ndjekjes së rekomandimeve. Qëllimi i tij është të ndihmojë në maksimizimin e rezultateve të auditimit dhe rritjen e kontributit në menaxhimin e qëndrueshëm të fondeve publike.

Korniza e Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t (IFPP) përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI). Sipas këtij kuadri, përgjegjësia kryesore për zbatimin në kohë dhe në mënyrë efektive të rekomandimeve u takon subjekteve të audituara. Ndërkohë, SAI-të janë përgjegjëse për ndjekjen dhe verifikimin e këtij zbatimi, duke vlerësuar masat e ndërmarra dhe efektivitetin e rezultateve. Procesi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, së bashku me iniciimin dhe zbatimin e masave korrigjuese nga subjektet e audituara, ofron informacion të detajuar mbi vlerën e shtuar të punës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe garanton profesionalizmin, pavarësinë dhe objektivitetin e institucionit.

Rishikimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit për auditimet financiare, të përputhshmërisë, të performancës dhe të teknologjisë së informacionit; realizimi i objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2023–2027, ku parashikohet se “Monitorimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga entet publike të audituara, në bashkëpunim me Kuvendin, do të jetë treguesi kryesor për matjen e ndikimit të punës audituese”; si dhe zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian në kuadër të integritetit evropian të vendit, sipas të cilit “Shqipëria duhet të marrë masa për zbatimin në kohë të rekomandimeve të auditimit të jashtëm publik” e bëjnë të domosdoshëm hartimin dhe zbatimin e një metodologjie bashkëkohore, të mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe në funksion të modernizimit të institucionit të auditimit të jashtëm publik në Shqipëri.





Në KLSH, ndjekja e zbatimit të rekomandimeve do të realizohet përmes Regjistrisë Elektronike Institucionale, i cili përfaqëson infrastrukturën TI të këtij procesi. Për të garantuar që informacioni të jetë gjithnjë i përditësuar, audituesit do të rifreskojnë statusin e rekomandimeve, në përputhje me afatet e përcaktuara për raportim nga subjektet e audituara, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Veçanërisht i rëndësishëm është informacioni i konsoliduar që do të gjenerohet për qëllime të raportimit periodik ndaj Kuvendit të Shqipërisë.

Qasjet dhe procedurat e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të paraqitura në këtë manual përfaqësojnë një hap drejt përmirësimit të indikatorëve të konsoliduar institucional për pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara.



2. TË PËRGJITHSHME

2.1 Qëllimi i Manualit

Manuali për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve përmban parimet, rregullat dhe procedurat që duhet të ndjekin audituesit e KLSH-së gjatë vlerësimit të masave të ndërmarra nga subjektet publike për zbatimin e rekomandimeve. Procedurat për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve kanë për qëllim identifikimin dhe dokumentimin e ndikimit të tyre në përmirësimin e veprimtarisë së institucioneve publike. Ky verifikim përbën një komponent thelbësor të procesit të auditimit, duke siguruar që rekomandimet e dhëna në auditimet e mëparshme të jenë zbatuar në mënyrë efektive dhe që çdo problem i evidentuar të jetë adresuar në mënyrë të përshtatshme.

Si i tillë, ai përfaqëson një vlerë të shtuar për performancën e KLSH-së dhe synon:

Finalizimin e çështjeve të identifikuara – Verifikimi i rekomandimeve garanton që problemet e evidentuara në auditimet e mëparshme janë adresuar siç duhet. Kjo ndihmon institucionet të zvogëlojnë risqet dhe të shmangin përsëritjen e të njëjtave probleme.

Rritjen e llogaridhënies – Zbatimi i rekomandimeve forcon kulturën e përgjegjësisë në institucion. Subjektet e audituara janë përgjegjëse për zbatimin në kohë dhe me efektivitet të masave korrigjuese, duke promovuar një mjedis më të përgjegjshëm.

Përmirësimi i vazhdueshëm – Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve ndihmon në forcimin dhe optimizimin e proceseve organizative. Ai mundëson evidentimin e fushave që kanë nevojë për përmirësim dhe promovon zhvillimin e qëndrueshëm të institucionit.

Menaxhimi i riskut – Zbatimi në kohë i rekomandimeve kontribuon në parandalimin dhe reduktimin e efekteve negative në veprimtarinë, financat dhe imazhin e subjekteve publike, duke garantuar mbrojtjen e interesave të palëve të interesuara.

Përputhshmëria dhe adresimi i gjetjeve të auditimit – Zbatimi i rekomandimeve tregon përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe politikat e brendshme të institucionit. Ai pasqyron angazhimin për adresimin e gjetjeve të auditimit dhe ruajtjen e integritetit institucional.

Optimizimin e përdorimit të burimeve – Monitorimi i rekomandimeve ndihmon në shpërndarjen më efektive të burimeve, duke përqendruar përpjekjet në fushat prioritare, në përputhje me rëndësinë e gjetjeve.

Rritjen e besimit të palëve të interesuara – Zbatimi sistematik i rekomandimeve forcon besimin e publikut dhe institucioneve të tjera në aftësinë e njësive publike për të menaxhuar rreziqet dhe për të përmirësuar performancën.

2.1 Qëllimi i Manualit

Ky manual synon të jetë një mjet praktik për rritjen e profesionalizmit të trupës audituese në shqyrtimin objektiv të masave korrigjuese, me qëllim identifikimin e mangësive, menaxhimin e risqeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit auditues.

Në funksion të këtij qëllimi, Manuali fokusohet në:

1. Një metodologji të detajuar dhe gjithëpërfshirëse për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, duke integruar veçoritë që karakterizojnë auditimet financiare, të përputhshmërisë, të performancës, tematik dhe të teknologjisë së informacionit.
2. Hartimin e një regjistri unik për regjistrimin dhe ndjekjen e rekomandimeve, i cili do të sigurojë informacion të plotë dhe të detajuar mbi implementimin e tyre dhe do të përmirësojë ndjeshëm efektivitetin e raportimit lidhur me progresin në zbatimin e tyre.

2.2 Baza Ligjore

Manuali i Zbatimit të Rekomandimeve Auditimit është hartuar duke u bazuar në:
Zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë:

Neni 163, ku përcaktohet se Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni që kontrollon veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore lidhur me përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe vendor, si dhe veprimtarinë ekonomike të personave juridik në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e aksioneve, ose huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Neni 164, i cili rregullon detyrimin e KLSH për të raportuar në Kuvendin e Shqipërisë lidhur si më poshtë:


1. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit: a) raport për zbatimin e buxhetit të shtetit; b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi; c) informacion për rezultatet e kontroleve sa herë që kërkohet nga Kuvendi.
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij.

Ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 15, (pikat a-ç) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, përcaktohen detyrimet e KLSH lidhur me:

- Informimin e drejtuesit të njësisë së audituar apo institucioneve të larta për shkeljet e akteve normative me pasojë dëme materiale dhe u rekomandon atyre korrigjimin, rregullimin ose ndryshimin e akteve ligjore;
- Informimin e drejtuesit të njësisë së audituar mbi parregullsitë dhe dëmet financiare gjatë administrimit të fondeve publike dhe t’u rekomandojë atyre që çdo shumë e përdorur në shkelje të ligjeve apo akteve nënligjore të kompensohet dhe të dëmshpërblehet në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji;
- Rekomandimin për drejtuesin e njësisë së audituar apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative;
- Përcjelljen tek organet e posaçme të shqyrtimit administrativ, sipas fushave përkatëse të kompetencës, gjetjet mbi shkeljet që janë objekt shqyrtimi, së bashku me dokumentet përkatëse të auditimit.

Në mënyrë specifike:

- Në nenin 15, pika j të ligjit organik të KLSH rregullohet mënyra e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve në të cilat përcaktohet se: “KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”;

- 
- Në nenin 15, pika k: “KLSH ka të drejtë t’u drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës në rast të moszbatimeve të rekomandimeve të dhëna nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
 - Në nenin 30, Pika 2: “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit”: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”

Raportin e vetëvlerësimit të KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 225, date 02.12.2022, ku sa i takon procesit të zbatimit të rekomandimeve, sugjerohet^[1] të konsiderohen:

- (1) praktika për vlerësimin e materialitetit me qëllim përcaktimin nëse një auditim mbi zbatimin e rekomandimeve kërkon hetime të mëtejshme; dhe
- (2) një procedurë më e qartë e zbatimit të rekomandimeve.

[1] Pika 4, fq 11_ https://drive.google.com/file/d/14Jz49b42uPA_5ofZhwBb490IZlcbS6q/view

INTOSAI - P 1 – Deklarata e Limës e konsideruar si Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit, në nenin 11 të saj “Zbatimi i gjetjeve nga Institucioni Suprem i Auditimit” përcakton që: *“Subjekti i audituar duhet të përcjellë informacion mbi rezultatet e auditimit, brenda një periudhe kohore të vendosur me ligj, ose nga Institucioni Suprem i Auditimit si dhe duhet të paraqesë masat e marra si rezultat i gjetjeve të auditimit”*.

INTOSAI - P 10 e njohur si “Deklarata e Meksikos mbi Pavarësinë e SAI-ve”, në parimin 7 të saj me titull “Ekzistenca e mekanizmave të ndjekjes së rekomandimeve të SAI-t” ku theksohet se *“Institucioneve Supreme të Auditimit u kërkohet që të kenë sistemin e tyre të brendshëm për të ndjekur dhe për t'u siguruar se subjektet e audituara i adresojnë saktë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre, sipas rastit këtu përfshihen edhe vërejtjet dhe rekomandimet e bëra nga parlamenti, një prej komisioneve të tij, ose bordi drejtues i subjektit të audituar”*.

INTOSAI - P 10 “Ekzistenca e mekanizmave efektivë mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të SAI-t”, parimi 7 në të cilin përcaktohet se “SAI-et i paraqesin raportet e tyre tek Ligjvënësi, një prej komisioneve të tij, ose një bordi i auditimit të qeverisë, sipas rastit, për rishikimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve specifike, në mënyrë që të ndërmerren veprime korrigjuese. - SAI-et kanë sistemet e tyre të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, për të siguruar që subjektet e audituara i kanë adresuar saktë vërejtjet, përfshirë ato të bërë nga Ligjvënësi, komisionet e saj apo bordi auditues i qeverisë, sipas rastit”

INTOSAI - P 12, 6 - 7 “Vlerat dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit-të besh diferencën në jetën e qytetarëve”. Ky parim thekson se: “SAI duhet të ketë një mekanizëm të përshtatshëm për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe ii) për raportimin në mënyrën më të përshtatshme të mundshme për masat e mara për zbatimin e rekomandimeve”.

INTOSAI - P 20 “Parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë”, parimi 3, “SAI-et miratojnë standarde auditimi, procese dhe metoda që janë objektive dhe transparente”.

- SAI-et kanë mekanizma vijuese efektive për ndjekjen dhe raportimin rekomandimeve për të siguruar që subjektet e audituara të trajtojnë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre, ashtu sikurse bëjnë me ato vërejtje dhe rekomandime të adresuara nga legjislativi (ISSAI 10 mbi parimin e pavarësisë).
- Procedurat ndjekëse i lejojnë SAI-t të sigurojnë informacion nga subjekti i audituar mbi masat korrigjuese të ndërmarra ose pse veprimet korrigjuese nuk janë ndërmarrë.

ISSAI 100 “Parimet Themelore të Auditimit në Sektorin Publik” përcakton qartazi rolin monitorues në procesin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga SAI dhe konkretisht: “SAI-et kanë rol në monitorimin e veprimeve të ndërmarra nga pala përgjegjëse në përgjigje të çështjeve të ngritura në raportin e auditimit. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, përqendrohet në faktin nëse subjekti i audituar ka adresuar në mënyrën e duhur çështjet e ngritura”.

ISSAI 140 “Menaxhimi i cilësisë së auditimit”, i rishikuar, i cili parashikon se SAI – et duhet të hartojnë, zbatojnë dhe operojnë bazuar në një sistem menaxhimi të cilësisë duke marrë parasysh natyrën dhe rrethanat e tyre. Në këtë standard, thuhet se SAI – të duhet të kryejnë auditime me cilësi të lartë për të përmbushur si objektivat e tyre strategjike ashtu edhe mandatin e tyre. Kjo qasje është në përputhje me Deklaratën e Rios dhe iniciativa të tjera të INTOSAI-t që inkurajojnë SAI - et të kenë ndikim përmes auditimeve të tyre.



ISSAI 300 “Parimet Themelore të Auditimit të Performancës”, pika 42, trajton me gjerësisht stadin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve si pjesë e ciklit të auditimit dhe konkretisht: “Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve i referohet ekzaminimit të veprimit korrigjues të ndërmarrë nga subjekti i audituar, ose një palë tjetër përgjegjëse, në bazë të rezultateve të një auditimi performance.

Ky është një aktivitet i pavarur që rrit vlerën e procesit të auditimit, duke forcuar ndikimin e tij dhe hedhjen e bazës për përmirësimin e procesit në vijim.

Procesi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve synon jo vetëm të verifikojë shkallën e zbatimit të tyre, por edhe të vlerësojë nëse subjekti i audituar ka trajtuar në mënyrë efektive mangësitë dhe problematikat që kanë shërbyer si bazë për rekomandimet, duke siguruar eliminimin e shkaqeve rrënjësore dhe shmangien e përsëritjes së tyre në të ardhmen.

ISSAI 400 “Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë”, pika 60, përcakton: “Procesi i zbatimit të rekomandimeve lehtëson zbatimin efektiv të veprimeve korrigjuese dhe siguron informacion të dobishëm për subjektin e audituar. Auditimet e kryera rregullisht për procedurat e zbatimit të rekomandimeve mund të jenë pjesë e vlerësimit të riskut për vitin pasardhës”.


Strategjia e Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit 2023 - 2027^[2], e cila ka përcaktuar në qëllimin strategjik nr. 2 “Rritjen e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve”, si një nga tre fushat për të cilat KLSH po punon gjatë kësaj periudhe. KLSH do të konkretizojë këtë qëllim strategjik duke:

- *Hartuar raporte auditimi*, të strukturuar, të qarta dhe të kuptueshme, në mënyrë që gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të interpretohen drejt nga palët e interesuara, duke kontribuar në rritjen e përdorimit të tyre dhe në forcimin e impaktit të auditimit;
- *Përdorur teknika të të shkruarit profesional*, i cili përcjell informacionet, gjetjet dhe rekomandimet në mënyrë të qartë, koncize dhe efektive.

Instrumentet kryesorë që përdor KLSH për realizimin e veprimtarisë gjurmuese të zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të kryera prej tij janë:

- Konsolidimi i strukturave të brendshme institucionale për të siguruar gjurmimin sistematik dhe periodik të zbatimit të rekomandimeve.
- Përdorimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për identifikimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimeve;
- Forcimi i bashkëpunimit me Kuvendin, në veçanti me Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave dhe Nën Komisioni për Auditimin e Sektorit Publik për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

[2] <https://drive.google.com/file/d/1s6ZZuuZ4RbPHektuPnNIs1DyPMnqnm-/view>



2.3 Përkufizime

Bazuar në Ligjit Nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH ushtron veprimtarinë audituese duke u fokusuar në kryerjen e auditimeve financiare, të përputhshmërisë, të kombinuara, të performancës dhe auditimeve të teknologjisë së informacionit. Në referencë të përcaktimeve të bëra në ligjin organik të KLSH-së por edhe në standardet ndërkombëtare të auditimit, këto auditime përkufizohen si më poshtë:

- ▶ *Auditim financiar* është një vlerësim i pavarur i pasqyrave financiare, në të cilin audituesi shpreh një opinion dhe jep një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare të vitit të fundit ushtrimor janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.
- ▶ *Auditimi i përputhshmërisë* është një proces sistematik i mbledhjes dhe vlerësimit objektiv të evidencës për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara ose gjendja aktuale përputhen me kriteret përkatëse. Auditimi i përputhshmërisë përfshin:
 - a) verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, i cili përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare, si dhe shprehjen e mendimeve për pasqyrat financiare;
 - b) verifikimin e përgjegjësisë financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme;
 - c) auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë dhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;
 - ç) auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe të funksionimit të auditimit të brendshëm;
 - d) auditimin e integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, dhe
 - dh) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’i bërë publike.
- ▶ Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizatave publike, duke iu përmbajtur ekonomikitetit dhe me synim identifikimin e përmirësimeve.
- ▶ Auditim i IT-së nënkupton një ekzaminim të zbatimit të sistemeve IT për të siguruar që ato përmbushin nevojat e subjektit të audituar, pa cënuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimtarisë së subjektit të audituar.

Rekomandim - Masë e propozuar që synon adresimin e shkaqeve dhe efekteve të parregullsive të evidentuara, me qëllim përmirësimin e performancës dhe funksionimit të njësisë së audituar.

Llojet e rekomandimeve paraqiten si vijon:

- Rekomandime për përmirësime ligjore;
- Rekomandime për masa organizative;
- Rekomandime për masa për shpërblim dëmi (në të ardhura dhe në shpenzime);
- Rekomandime për eliminimin e efekteve negative të përdorimit të fondeve publike -3E (në të ardhura dhe në shpenzime);
- Rekomandime për masa administrative;
- Rekomandime për masa disiplinore;



KREU 3

PROCESI I NDJEKJES SË REKOMANDIMEVE

3. PROCESI I NDJEKJES SË REKOMANDIMEVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përmbushje të detyrimeve që i burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe me qëllim informimin e Kuvendit dhe opinionit publik mbi statusin e pranimiit dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara, ndjek një proces të strukturuar dhe efektiv për monitorimin dhe ndjekjen e tyre. Ky proces fokusohet në vlerësimin e përmirësimeve dhe rezultateve të arritura si rezultat i punës audituese. Ai analizon nëse rekomandimet e auditimit janë zbatuar në mënyrë efektive dhe nëse kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit, forcimin e kontrollit të brendshëm, uljen e riskut dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve.

Në kontekstin e standardeve të INTOSAI-t, monitorimi dhe ndjekja e pranimiit dhe zbatimit të rekomandimeve i referohen procesit të vlerësimit të masave që subjekti i audituar ka ndërmarrë për të adresuar në mënyrë të përshtatshme gjetjet dhe për të zbatuar rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme. Në varësi të veçorive të institucioneve supreme të auditimit (SAI), kjo fazë zhvillohet pas një periudhe të arsyeshme kohe, për të lejuar zbatimin e masave korrigjuese.


Departamentet e auditimit në KLSH, janë përgjegjës për monitorimin e këtij procesi, duke ofruar drejtim dhe mbështetje në vlerësimin e rekomandimeve dhe në përgatitjen e raporteve të sakta mbi zbatimin e tyre. Në realizimin e misionit të auditimit për ndjekjen e rekomandimeve, grupi i auditimit i ngarkuar me këtë detyrë duhet të jetë plotësisht i angazhuar për të vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive veprimet e subjekteve të audituara, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të mëparshme.

Grupi i auditimit duhet të ndjekë me përpikmëri hapat e procesit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe ta dokumentojë atë me kujdes. Gjithashtu, ai duhet të vlerësojë profesionalisht statusin e rekomandimeve dhe përpjekjet e subjekteve të audituara për zbatimin e planit të veprimit të hartuar. Kjo qasje siguron krijimin e një sistemi efektiv të monitorimit, të përshtatshëm për arritjen e rezultateve duke garantuar që të gjitha rekomandimet të jenë zbatuar siç është parashikuar.

Monitorimi aktiv dhe ndjekja e statusit të zbatimit të rekomandimeve nga KLSH përfshin:

- Përpunimin dhe vlerësimin e informacionit të marrë përmes përgjigjes 20-ditore të subjekteve të audituara, me qëllim verifikimin e statusit të pranimiit të rekomandimeve;
- Përpunimin dhe analizimin e informacionit të marrë përmes përgjigjes 6-mujore të subjekteve të audituara, me qëllim verifikimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve;
- Analizimin e masave të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve dhe rezultateve të arritura, përmes verifikimit në terren;
- Marrjen e masave të nevojshme, për subjektet e audituara, në rastet kur progresi në zbatimin e rekomandimeve rezulton i pamjaftueshëm.

Procesi i auditimit të zbatimit të rekomandimeve në KLSH, paraqitet në grafikën si vijon:



Sistemi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve synon monitorimin e statusit të të gjitha rekomandimeve deri në zbatimin e plotë të tyre nga subjektet e audituara. Një aspekt i rëndësishëm i këtij procesi është vlerësimi i opsioneve dhe strategjive të mundshme që mund të ndihmojnë subjektin e audituar në arritjen e zbatimit efektiv të rekomandimeve, sidomos në rastet kur konstatohet mungesë progresi.

Ky proces mbështetet drejtpërdrejt nga Regjistri i Ndjekjes së Rekomandimeve (i miratuar sipas formatit në Aneksin nr. 1), i cili përditësohet rregullisht nga sektori i statistikave. Përditësimi kryhet në përputhje me afatet e përcaktuara dhe me informacionin e siguruar përmes mekanizmave të ndryshëm të aplikuar nga KLSH, si:

- Raportimi gjashtëmujor i subjekteve të audituara mbi zbatimin e planit të masave;
- Auditimet e posaçme të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve;
- Auditimet pasuese



Grupet e auditimit për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, duhet të ndërmarrin hapa shtesë për të verifikuar vështirësitë e zbatimit të tyre, mbështetur në evidencat përkatëse. Aty ku vlerësohet e nevojshme dhe me miratimin e Kryetarit të KLSH-së, mund të përcaktohen afate të reja për zbatimin e rekomandimeve, të cilat garantojnë përmbushjen e objektivave për të cilat është dhënë rekomandimi. Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë se relevanca dhe zbatueshmëria e problemit, çështjes apo rekomandimit mund të reduktohet si pasojë e ndryshimeve në mjedisin e jashtëm.

“

KLSH ndjek zbatueshmërinë e rekomandimeve, deri në 3 vite pas afatit fillestar. Në rast se, në përfundim të afatit 3 – vjeçar, statusi i rekomandimit ende nuk ka ndryshuar për shkak se nuk janë marrë masat e duhura nga subjekti përgjegjës (por rekomandimi vijon të jetë i vlefshëm), atëherë këto rekomandime i përcillen Kuvendit, në mënyrë që Kuvendi nëpërmjet mekanizmave të vetë të nxisë zbatimin e plotë të tyre. Pas kësaj, në Regjistrin e Ndjekjes së Rekomandimeve, do të përditësohet statusi i këtyre rekomandimeve, duke u përzgjedhur statusi “përcjellë Kuvendit”.

”



3.1 Pranueshmëria e Rekomandimeve (Vetëdeklarimi 20 – ditor i Subjektit)

Në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", subjektet e audituara janë të detyruara të përgatisin dhe dërgojnë në KLSH një plan masash për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH pas 20 ditësh^[3] nga momenti i marrjes së raportit përfundimtar të auditimit.

Plani i masave për zbatimin e rekomandimeve i përcjellë në KLSH nga subjekti duhet të shprehet mbi pranueshmërinë e çdo rekomandimi, strukturat përgjegjëse për zbatimin e tij dhe afatet kohore. Në këtë fazë të procesit, duke qenë se zbatimi i rekomandimeve mund të marrë kohë, është e rëndësishme që subjekti të sjellë domosdoshmërisht informacion mbi pranueshmërinë e rekomandimit, shoqëruar me argumentat përkatëse, në rastet kur rekomandimi nuk pranohet ose pranohet pjesërisht.

Në përfundim të çdo auditimi, pas dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit:

● Në rastet kur subjektet dërgojnë shkresën për kthim përgjigjeje 20 ditore, Sektori i Protokoll – Arkivës e dërgon menjëherë një kopje të saj pranë strukturës përgjegjëse për statistikën dhe Departamentit të Auditimit përkatës.

● Në rastet kur subjekti nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor, Departamenti i Auditimit përkatës/Përgjegjësi i grupit, 5 ditë pas përmbushjes së afatit ligjor 20 ditor konfirmojnë nëpërmjet postës elektronike, tek struktura përgjegjëse për statistikën në KLSH, mos përmbushjen e detyrimit ligjor nga subjekti. Në këtë rast, për efekt raportimi, rekomandimet do të konsiderohet "i pranuar" dhe regjistrohen si të tilla në Regjistrin e Ndjekjes së Rekomandimeve.

Në vijim, struktura përgjegjëse për statistikën plotëson në Regjistër^[4] fushat përkatëse, duke mbajtur në konsideratë statusin e pranueshmërisë së rekomandimit, si më poshtë vijon:

☒ "pranuar plotësisht"

☐ "pranuar pjesërisht"

☒ "pa pranuar"

“

Në rastin e rekomandimeve të pa pranuar në përgjigjen 20 ditore, nga subjektet e audituara, grupi i auditimit, në verifikimin e radhës duhet të shprehet mbi argumentimin e shkaqeve të pa pranueshmërisë. Ky proces ka për qëllim të identifikojë arsyet që kanë çuar në refuzimin e rekomandimeve dhe të sigurojë që çdo kundërshtim të trajtohet në përputhje me rregullat dhe praktikën e pranueshme.

Në përfundim të këtyre verifikimeve, lista me rekomandimet e papranuara pa shkaqe të qënësishme, i përcillet Kuvendit me qëllim nxitjen e zbatimit të tyre.

”

[3] Ligji nr.154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Neni 15, pika J

[4] Një sqarim mbi plotësimin e evidencës statistikore të pranueshmërisë së rekomandimeve, e gjeni në Aneksin 1.1, bashkëngjitur këtij Manuali

3.1.1 Statusi i Pranueshmërisë së Rekomandimeve

Me qëllim standardizimin e terminologjisë në nivel institucioni dhe konsolidimin e raportimit të performancës institucionale për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ndaj subjekteve të audituara, në vijim paraqiten përkufizimet lidhur me statusin e pranueshmërisë së rekomandimeve.

Paraprakisht, një rekomandim i KLSH-së mund të pranohet ose të mos pranohet (të refuzohet) nga subjekti i audituar.



Rekomandim i pranuar

Rekomandimi i KLSH-së konsiderohet i shqyrtuar nga subjekti i audituar dhe i përfshirë në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili duhet t'i jetë dërguar KLSH-së brenda afatit 20-ditor nga përcjellja e raportit të auditimit, si dhe të informojë pranë KLSH-së pas përfundimit të afatit 6-mujor mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Në rastet e mungesës së dokumenteve të sipërpërmendura, rekomandimi konsiderohet i pranuar, me arsyetimin se subjekti i audituar nuk ka paraqitur argumente me shkrim për mospranimin e tij.



Rekomandim i pranuar pjesërisht

Rekomandimi i KLSH-së konsiderohet i pranuar pjesërisht nga subjekti i audituar dhe i reflektuar në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, kur subjekti shpreh dakordësi vetëm për një pjesë të përmbajtjes së rekomandimit, ndërsa për pjesën tjetër paraqet kundërshtime ose mosdakordësi.



Rekomandim i papranuar

Në rastet kur për një ose disa rekomandime subjekti i audituar ka refuzuar me shkrim, duke dhënë shpjegimet përkatëse, audituesi e konsideron rekomandimin/rekomandimet si të papranuara (të refuzuara) nga subjekti.

Në këtë kuptim, rekomandimi konsiderohet i papranuar vetëm kur subjekti është shprehur në mënyrë të shkruar ose kur në dokumentacionin shkresor të subjektit evidentohet qartë një veprim i tillë.

3.2 Zbatueshmëria e Rekomandimeve

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve është një përgjegjësi e vazhdueshme e institucionit dhe statusi i të gjithë rekomandimeve duhet të përcaktohen në baza të planifikuara rregullisht. Kjo ndihmon për të siguruar që asnjë rekomandim të mos mbetet pa status të përditësuar.

Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve në KLSH kryhet në 3 mënyra:

1

Nëpërmjet **vetëdeklarimit 6 mujor** të vetë subjekteve të auditimit, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30

2

Nëpërmjet përfshirjes së zbatimit të rekomandimeve si drejtim i veçantë në programin e auditimit

3

Nëpërmjet kryerjes së auditimit të zbatimit të rekomandimeve me program të dedikuar

Duhet theksuar se, KLSH do të fillojë verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, sipas pikave 2 dhe 3, **vetëm pas përfundimit të afatit ligjor 6 - mujor** që subjekti ka në dispozicion për vetëdeklarimin mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve të pranuar. Vetëdeklarimi i zbatueshmërisë bëhet në përputhje me planin e masave të dërguar në KLSH, brenda 20 ditëve pas dorëzimit të raportit përfundimtar të auditimit.

[4] Një sqarim mbi plotësimin e evidencës statistikore të zbatueshmërisë së rekomandimeve, e gjeni në Aneksin 1.1, bashkëngjitur këtij Manuali

Për verifikimin e rekomandimeve, KLSH konsideron statuset si më poshtë:

Statusi i rekomandimit	Shpjegim mbi përzgjedhjen e statusit
Zbatuar plotësisht	Rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar plotësisht , në rastet kur veprimet e ndërmarra përmbushin qëllimin e rekomandimit dhe problemet janë korrigjuar. Strukturat dhe proceset janë në vend për të parandaluar përsëritjen e mangësive dhe u ofrohen evidenca të mjaftueshme për të demonstruar veprimet e ndërmarra.
Zbatuar pjesërisht	Rekomandimi do të konsiderohet i zbatuar pjesërisht , kur nga vlerësimi i audituesit evidentohet se subjekti i audituar ka ndërmarrë masa korrigjuese për adresimin e tij, por zbatimi nuk është përfunduar plotësisht dhe jo të gjitha veprimet e kërkuara për arritjen e rezultatit të synuar janë realizuar. Në këto raste, pavarësisht përpjekjeve për përmirësim, vijnë të ekzistojnë mangësi ose elemente të paadresuara në sistemet, kontrollet apo procedurat përkatëse, dhe rezultati i pritshëm i rekomandimit nuk është arritur në tërësi. Gjithashtu kur afati i përcaktuar për zbatimin e plotë të rekomandimit ka kaluar, por masat e ndërmarra janë realizuar vetëm pjesërisht dhe rekomandimi nuk është përmbushur brenda afatit të kërkuar. Në këto kushte, rekomandimi mbetet në proces ndjekjeje deri në përfundimin e plotë të veprimeve të nevojshme dhe arritjen e efektit të synuar.
Pazbatuar	Rekomandimi do të konsiderohet i pazbatuar , në rastet kur subjekti i auditimit nuk vë në dispozicion të audituesit asnjë dokument që mund të shqyrtohet për të vlerësuar statusin e zbatimit të rekomandimit. Subjekti nuk ka marrë asnjë veprim për zbatimin e rekomandimit, edhe pse mund të jetë përfshirë në planin e veprimit.



Statusi i rekomandimit	Shpjegim mbi përzgjedhjen e statusit
Rekomandimi nuk është më i aplikueshëm	Rekomandimi nuk është më relevant/i aplikueshëm , në rastet kur kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në kuadrin organizativ, teknologjik ose ligjor që e bëjnë atë të papërshtatshëm ose të panevojshëm. Në veçanti, ndryshimet në kuadrin ligjor – si hyrja në fuqi e ligjeve të reja, shfuqizimi i dispozitave ekzistuese apo përditësimi i standardeve rregullatore – mund të ndikojnë drejtpërdrejt në vlefshmërinë e një rekomandimi, duke e bërë atë jo më në përputhje me kërkesat aktuale ligjore ose duke e adresuar tashmë përmes dispozitave të reja. Po ashtu, nëse rekomandimi lidhet me një proces që është zëvendësuar ose eliminuar, ose nëse rreziku i identifikuar nuk ekziston më, atëherë ai mund të klasifikohet si i tejkaluar dhe të hiqet nga plani i veprimit, pa cënuar objektivat e kontrollit apo përputhshmërinë ligjore të organizatës.
Përcjellë Kuvendit	Rekomandimi me status “Përcjellë Kuvendit” , do të përzgjidhet në rastet kur: (i) është përmbushur afati 3 vjeçar nga afati fillestar i rekomandimit, dhe ky rekomandim ende ka mbetur pa zbatuar plotësisht; ose (ii) për rekomandime të tjera me rëndësi të veçantë, që në vlerësimin audituesve dhe me miratimin e Kryetarit të KLSH-së, kërkojnë të përcillen në Kuvend për të nxitur zbatueshmërinë e plotë të tyre, edhe pse ende nuk është përmbushur afati 3 vjeçar.

Gjatë procesit, audituesit duhet të mbajnë në konsideratë:

- ▶ Në rastin e rekomandimeve për shpërblim dëmi, të vlerësojnë dokumentacionin e nxjerrë nga subjekti i audituar lidhur me procedurën e ndjekur, sipas rekomandimit. Të vlerësohet mbi bazën e dokumentacionit vërtetues të lëshuar për procedurën (p.sh., nxjerrjen e urdhrit nga titullari i institucionit për arkëtimin e dëmit, kontabilizimin e vlerës së dëmit e deri në përcjelljen në gjykatë të padisë për arkëtimin e dëmit).
- ▶ Në rastin e rekomandimeve për menaxhim jo efektiv, aty ku është e mundur, audituesi përvec statusit të masës, duhet edhe të vlerësojë nëse nga përmirësimi i procesit që ka shkaktuar efektin financiar, fondet në vijim janë menaxhuar me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë.
- ▶ Në rastin e rekomandimeve për masa disiplinore, **nëse rekomandimi i është lënë Titullarit** të njësisë së audituar, audituesi shqyrton p.sh. nxjerrjen e urdhrit për kalimin e çështjes në komisionin e disiplinës dhe veprimet pasuese të tij. Në rastet e rekomandimeve të masave disiplinore për punonjësit, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e punës, shqyrtohet drejtpërdrejtë akti i nxjerrë nga titullari për rekomandimin e dhënë (përfshirë ndjekja e procesit gjyqësor nëse çështja midis palëve, është përcjell për gjykim nga organet e drejtësisë).
- ▶ Në rastin e rekomandimeve për masa administrative, lidhet përgjithësisht me veprimin dhe mosveprimin e institucioneve përkatëse ndëshkuese. Në këtë rast, vlerësohet nëse subjekti ka proceduar në një linjë me rekomandimin e KLSH-së, si dhe verifikimin e dokumentacionit të procedurës së ndjekur nga subjekti, ashtu edhe përgjigja e institucioneve përkatëse nëse ka ardhur, për shkak të ezaurimit të plotë të masës së rekomanduar.



Sistem efektiv i monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve:

KLSH ndjek një proces efektiv të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve për çdo subjekt të audituar, duke u fokusuar në identifikimin e përmirësimeve të bëra si rezultat i punës audituese dhe arritjes së rezultateve të pritshme si dhe evidenton vazhdimisht rezultatet në Regjistrin e Ndjekjes së Rekomandimeve me qëllim gjenerimin e raporteve me informacione të dobishme për këtë proces.

Vëmendje e veçantë për rekomandimet kryesore: KLSH duhet të sigurohet që rekomandimet kryesore janë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe në rastet kur nevojitet, duhet të rivlerësohen strategjitë për të siguruar ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme deri në realizim të tyre.

Gjithashtu duhet të vlerësohen dhe të merren në konsideratë edhe faktorë të tjerë jashtë subjektit auditues si dhe institucionet eprorë në shkallë hierarkike, të cilët mund të ndihmojnë në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme lidhur me zbatimin e plotë të rekomandimeve me rëndësi të veçantë.

Për realizimin në mënyrë efektive dhe eficiente të procesit të zbatimit të rekomandimeve, në përfundim të çdo auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve, Departamentet e auditimit/përgjegjësit e grupeve të auditimit dërgojnë pranë strukturës përgjegjëse për statistikën:



Kopje elektronike të editueshme të Vendimit të Kryetarit me ekstremitetet përkatëse (numër, datë vendimi dhe numër protokollit),



Raportin Përfundimtar të Auditimit (të editueshëm)



Evidencat statistikore të auditimit (sipas Aneksit 2 bashkëlidhur këtij Manuali).



3.2.1 Procesi i Verifikimit të Zbatimit të Rekomandimeve nëpërmjet Vetëdeklarimit 6 – Mujor

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30, subjektet e audituara, kanë detyrimin që të përgatisin dhe dërgojnë në KLSH, përgjigje mbi statusin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Subjektet e audituara, pas 6 muajsh^[5] duhet të dërgojë një informacion të hollësishëm mbi planin e zbatimit të rekomandimeve, për të gjitha ato rekomandime që janë pranuar sipas planit të masave të dërguar nga subjekti në KLSH, 20 ditë pas përfundimit të auditimit.

Spektori i protokoll – arkivës dërgon pranë strukturës përgjegjëse për statistikën në KLSH dhe Departamentit të Auditimit përkatës/Përgjegjësit të grupit të auditimit, një kopje të shkresës së kthimit të përgjigjes së subjektit. Në rastet kur subjekti nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 6-mujor, Departamenti i Auditimit përkatës/Përgjegjësi i grupit konfirmojnë tek struktura përgjegjëse për statistikën në KLSH, mos përmbushjen e detyrimit ligjor nga subjekti, nëpërmjet postës elektronike dhe evidencat statistikore periodike.

Në vijim struktura përgjegjëse për statistikën në KLSH plotëson më këto të dhëna Regjistrin e Ndjekjes së Rekomandimeve. Në këtë fazë të procesit, është e rëndësishme të verifikohet statusi i zbatueshmërisë, nisur nga shkresat e kthimit të përgjigjes si më poshtë:

Subjekti ka kthyer përgjigje 6 mujore

- “zbatuar plotësisht”
- “zbatuar pjesërisht”
- “pa zbatuar”
- “rekomandimi nuk është më relevant/i aplikueshëm”

Subjekti nuk ka kthyer përgjigje 6 mujore

- “pa përgjigje 6 mujore”



Kujdes veçanërisht duhet të tregojë Departamenti i Auditimit të Performancës në adresimin e rekomandimit, pasi duhet ndarë përgjegjësia e secilit institucion në lidhje me pjesën takuese të procesit. Kjo pasi në momentin që verifikohet zbatueshmëria, të mund të identifikohet lehtë se cili institucion ka qenë përgjegjës dhe çfarë përgjigje ka dhënë ai për masën (dhe jo institucionet e tjera të përfshira në proces).

3.2.2 Procesi i Verifikimit të Zbatimit të Rekomandimeve në Auditimet e Radhës, si Drejtim i Veçantë në Programin e Auditimit

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve në auditimet e radhës duhet të planifikohet gjithmonë si një drejtim i veçantë brenda programit të auditimit, në ato raste kur, për shkak të kërkesave ligjore dhe rregullatore, procesi i auditimit kryhet çdo vit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për auditimin e njërive të vetëqeverisjes vendore dhe/ose subjekteve të tjera, si Ministria e Financave, FSDKSH, ISSH, etj.

Audituesi/it, të cilët, sipas formularit të ndarjes së detyrave janë ngarkuar me detyrën e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, përpara fillimit të auditimit, kërkojnë nga struktura përgjegjëse për statistikën në KLSH, pjesën takuese të Regjistrit të Ndjekjes së rekomandimeve.

Struktura përgjegjëse për statistikën, brenda 5 ditëve vendos në dispozicion të audituesit të dhënat, mbi të cilat ky i fundit duhet të mbështetet për të verifikuar zbatueshmërinë e rekomandimeve.

Pas përfundimit të auditimit dhe dërgimit në subjekt të Raportit Përfundimtar, përgjegjësi i grupit të auditimit/personi i ngarkuar me mbajtjen e statistikës, plotëson dhe ridërgon elektronikisht pranë strukturës përgjegjëse për statistikën, Evidencën 1.1 të Aneksit 2, bashkëngjitur këtij Manuali, të përditësuar me rezultatet e zbatueshmërisë së rekomandimeve, të lëna në auditimin e mëparshëm.

Përgjegjësi i grupit të auditimit/personi i ngarkuar me mbajtjen e statistikës plotëson fushat përkatëse që lidhen me “zbatueshmërinë pas verifikimit në terren”, me statusin si më poshtë:

- “zbatuar plotësisht”
- “zbatuar pjesërisht”
- “pa zbatuar”
- “rekomandimi nuk është më relevant/i aplikueshëm”

Nëse “Zbatimi i rekomandimeve” është pjesë e auditimit të radhës, atëherë për rekomandimet që janë pjesërisht të pazbatuara ose të pazbatuara dhe janë evidentuar edhe gjatë auditimit të kryer nga grupi, në zbatim të programit të auditimit, në seksionin “Komenti i grupit të auditimit” të shënohet:

Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që vijnë të jenë të pazbatuara/ pjesërisht të pazbatuara. Trajtimi më i detajuar i këtyre masave është paraqitur tekçështja përkatëse, sipas programit të auditimit nr. __, datë __.

Rekomandimet e përsëritura do të unifikohen në një të vetme dhe do të rikërkohen për zbatim në vijim të këtij auditimi.



Struktura përgjegjëse për statistikën, përditëson të dhënat e Regjistrit të Ndjekjes së Rekomandimeve, me pjesët takuese për secilin auditim dhe departament rast pas rasti, duke reflektuar rezultatet mbi statusin e zbatueshmërisë së rekomandimeve.

Paralelisht me Evidencën 1.1, grupi i auditimit plotëson edhe Evidencën 1.2 të Aneksit 2, të cilat në përputhje me Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH, i dërgohen për konfirmim dhe firmë edhe strukturës përgjegjëse për statistikën në KLSH, të paktën 5 ditë përpara afatit përfundimtar të arkivimit të dosjes së auditimit.



3.2.3 Procesi i Verifikimit të Zbatimit të Rekomandimeve si Auditim me Program të Dedikuar (Tematik)



Procesi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve si auditim me program të dedikuar duhet të jetë pjesë e planifikimit vjetor të auditimeve.

Për efekt të planifikimit dhe raportimit të zbatueshmërisë së rekomandimeve, auditimi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve do të kryhet dy herë në vit përkatësisht: auditim i posacëm për vitin N+1 për auditimet e evaduara në gjashtëmujorin e parë të vitit N dhe auditim i posacëm për vitin N+1 për auditimet e evaduara në gjashtëmujorin e dytë të vitit N.



Për auditimet e performancës, të evaduara gjatë vitit të mëparshëm, verifikimi në terren i zbatimit të rekomandimeve bëhet **dy herë në vit**, ndërsa statusi i tyre (mbi pranueshmërinë dhe zbatueshmërinë), do të vijojë të raportohet mbi bazën e deklarimeve të vetë subjekteve, mbështetur në shkresat e kthimit të përgjigjeve 20 ditore dhe 6 mujore, sikundër diktojnë nenet 15 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Në vijim të këtij procesi, do të realizohet dhe një aneks i konsoliduar i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, duke përfshirë të gjitha institucionet dhe të gjitha rekomandimet që rezultojnë me status "pjesërisht të zbatuara" dhe "të pazbatuara", pasi të ketë përfunduar afati i përcaktuar i zbatimit të tyre.

Aneksi do të mbulojë rekomandimet e dala nga auditimet e viteve të mëparshme, duke respektuar afatin maksimal 3-vjeçar për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Në këtë mënyrë bëhet e mundur që krahas unifikimit të aneksit, KLSH të ketë rezultate të plota dhe të konsoliduara të zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e evaduara vitin e mëparshëm dhe brenda vitit në vijim (me qëllim raportimin në nivel institucional, brenda viti pasardhës).

Në grafikën që vijon, paraqitet procesi i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve me program të dedikuar:

AUDITIM TEMATIK

HAPI I

Drejtorët e departamenteve të auditimit hartojnë Programin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, dokument që së bashku me Njoftimin për fillim auditimi (sipas dokumenteve standard të Rregullores së Procedurave të Auditimit), u vihen në dispozicion grupeve të caktuara për realizimin e këtyre auditimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet sipas drejtimeve të mëposhtme:

- Verifikimi mbi zbatimin e afatit ligjor, 20 ditore të kthimit të përgjigjes mbi pranueshmërinë e rekomandimeve dhe planin e punës për zbatimin e tyre;
- Kërkimin e shpjegimeve nga Titullari i Institucionit të audituar, në rast të konstatimit të vonës në kthimin e përgjigjes jashtë afatit apo shkaqeve mbi moskthimin e përgjigjes;
- Verifikimin e plotësisë dhe saktësisë të programeve të hartuar (plan veprimi ose programi i masave) bazuar në shkresën përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit me rekomandimet, mbërritur në subjektet e audituara;
- Verifikimin e zbatimit të afatit ligjor 6 – muor nga data e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit., lidhur me realizimin e planit të punës të deklaruar në përgjigjen 20-ditore, dhe konkretisht ecurisë së zbatimit të rekomandimeve.
- Verifikimin e nxjerrjes së akteve administrative përkatëse (urdhrrat).

HAPI II

Përpara fillimit të verifikimit në terren për zbatimin e rekomandimeve, me kërkesë të drejtuesit të Departamentit, struktura përgjegjëse për statistikën, vendos në dispozicion të departamentit/grupit përkatës të auditimit, pjesën takuese të Regjistrit të Ndjekjes së Rekomandimeve, për të gjitha rekomandimet për ato subjekte/tema të përfshira në Programin e Auditimit përkatës.

Gjithashtu, grupi i auditimit, nevojitet të mbledhë edhe dokumentet për secilin subjekt/temë auditimi, që janë:

- Vendimi i Kryetarit të KLSH-së për auditimin për të cilin do të verifikohet zbatueshmëria;
- Shkresën përcjellëse të rekomandimeve dërguar subjektit të audituar;
- Përgjigjen e subjektit të audituar shoqëruar me planin e veprimit në zbatim të rekomandimeve;
- Komunikime të tjera me subjektin në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve (nëse ka).

HAPI III

Verifikimi në terren i zbatueshmërisë së rekomandimeve

Audituesit duhet të ndjekin me korrektesë, të dokumentojnë me kujdes dhe të vlerësojnë me profesionalizëm statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe aktivitetin e subjekteve të audituara në ndjekjen e planit të veprimit të hartuar në lidhje me zbatimin e këtyre rekomandimeve.



Gjatë auditimit në terren, vlen të theksohet se, në rastin e urdhrave administrative të lëshuar nga Titullari i subjektit, **në lidhje me shpërblimin e dëmit** dhe vendimet e gjobave nga personat e ngarkuar me ligj, nga grupi i auditimit verifikohet:

- regjistrimi në kontabilitet i vlerës së shpërblimit të dëmit dhe si është kryer ndjekja e procesit të ndalesave;
- regjistrimi në kontabilitet i vlerës së gjobave të vendosura nga Agjencia e Prokurimit Publik, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, etj., dhe zbatimi i afateve ligjore të nxjerrjes së vendimeve për vjeljen e tyre, duke nxjerrë dhe përgjegjësinë materiale ndaj personave përgjegjës, sipas përcaktimeve të nenit 46 “Parashkrimi i dënimit administrativ”, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- lëshimi i urdhrave ekzekutiv nga gjykata për vendimet e kundërvajtjes administrative nga gjykata, sipas nenit 24 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv”.

Grupi i auditimit verifikon dhe dokumenton me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit dhe vjeljen e gjobave të vendosura, nga Titullari i subjekteve dhe njësia e ngarkuar prej tij.

Në rast të verifikimit të kalimit të afateve të parashkrimit ligjor të kërimit të shpërblimit të dëmit apo pagesave të përfituara tepër, të përcaktuara në nenin 115 të Kodit Civil, apo nenin 203 të Kodit Punës, për shkak të mosndjekjes në vijimësi nga ana e subjektit të audituar të përcaktohet rast pas rasti përgjegjësia individuale dhe institucionale.



Në lidhje me zbatimin e masave administrative ose disiplinore, grupi i auditimit verifikon nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore apo administrative, komunikimin zyrtar personave përkatës, vendosjen në dosjen personale të nëpunësit në vendimin përfundimtar dhe njoftimi për Departamentin e Administratës Publike dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, etj. Verifikimet përfshijnë:

- Veprimet e strukturës së burimeve njerëzore, përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve, pjesë e shërbimit civil të institucionit, nëse për masat e rekomanduara nga KLSH, ka ndërmarrë hapat e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e Komisionit Disiplinor, siç parashikohet në Kreun I, neni 10 të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar;
- Veprimet e Titullarit të subjektit në cilësinë e eprorit, për marrjen e masave disiplinore sipas rekomandimeve të KLSH-së dhe në zbatim të VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor (KD) në shërbimin civil”, (në vijim shkurt VKM), duke analizuar: (i) vlerësimin e pretendimeve për shkeljet disiplinore sipas pikës 7, të VKM, si dhe klasifikimi i shkeljeve sipas pikës 9, të VKM dhe pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013; (ii) zbatimin e procedurave për shkelje që klasifikohet të lehta, për masën disiplinore “Vërejtje”, parashikuar në nenin 58 pika 2 shkronja (a) të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013, i ndryshuar; (iii) kërkesën ndaj Komisionit Disiplinor që të fillojë ecurinë disiplinore, sipas pikës 10 dhe 11 të VKM apo dërgimin me shkresë zyrtare të kërkesës për ecuri disiplinore pranë organit kompetent, kur shkelja që i adresohet nëpunësit, rezulton se nuk është klasifikuar drejt apo nuk është në juridiksionin lëndor të organit disiplinor që e ka marrë në shqyrtim kërkesën, sipas pikës 12 të VKM; (iv) veprimet e Komisionit Disiplinor me marrjen në dijeni për shkeljet disiplinore të rekomanduara nga KLSH (për punonjësit pjesë e shërbimit civil), dokumentimi dhe fillimi i procedurave për ecurinë disiplinore, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013, i ndryshuar, dhe VKM nr.115, datë 05.03.2014. Veprimet e eprorit direkt, në rast se marrëdhënia e punës rregullohet me Kodin e Punës, masat disiplinore të parashikuara në kontratën kolektive apo individuale të punës (nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në R.SH”, i ndryshuar).

HAPI IV

Në përfundim të auditimit në terren, të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, bëhet vlerësimi dhe përcaktimi i shkallës së zbatimit të tyre.

Mbi bazën e kritereve të sqaruara më parë, **në përfundim të auditimit në terren**, të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, bëhet vlerësimi dhe përcaktimi i shkallës së zbatimit të tyre, si më poshtë:

- “zbatuar plotësisht”
- “zbatuar pjesërisht”
- “pa zbatuar”
- “rekomandimi nuk është më i aplikueshëm”

HAPI V

Audituesit përgatisin dhe dërgojnë në subjekt Projekt raportin dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit, në përputhje me Rregulloren e Procedurave të Auditimit (*shtjelluar më tej në Kreun 4 “Raportimi” të këtij Manuali.*)

Në përputhje me afatet e parashikuara në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, në përfundim të auditimit në terren hartohen:

- Projekt Raporti i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve.
- Raporti Përfundimtar i auditimit të zbatimit të rekomandimeve.
- Në rastet kur zbatimi i rekomandimeve kryhet në auditimet e radhës si drejtim i vecantë në programin e auditimit, pjesa takuese e Raportit Përfundimtar të Auditimit përkatës (dhe rezultatet e këtij verifikimi përpunohen nga sektori përgjegjës për statistikën dhe bëhen pjesë e raportit përmbledhës të zbatimit të rekomandimeve në nivel institucional).

HAPI VI

Grupet e auditimit, në përputhje me Rregulloren e Procedurave të Auditimit dërgojnë pranë sektorit përgjegjës për statistikën në KLSH, evidencat statistikore përkatëse.

Pas dërgimit të Raportit përfundimtar të auditimit tematik të zbatimit të rekomandimeve, departamentet e auditimit, të paktën **5 ditë përpara** afatit përfundimtar të arkivimit, personat përgjegjës, të caktuar për të mbajtur evidencat statistikore plotësojnë dhe dërgojnë tek struktura përgjegjëse për statistikën:

- Vendimin e editueshëm, dhe të plotësuar me ekstremitetet përkatëse (nr vendimi, datë dhe nr. protokollit)
- Raportin Përfundimtar të Auditimit, version i editueshëm
- Evidencat 1 dhe 2, të Aneksit 2 bashkëlidhur këtij Manuali.

HAPI VII

Sektori përgjegjës për statistikën, popullon më pas Regjistrin e Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve dhe përgatit Raportin Përmbledhës të Zbatimit të Rekomandimeve në nivel Institucional (*shtjelluar më tej në Kreun 4.2 të këtij Manuali.*)



KREU 4

RAPORTIMI

4.RAPORTIMI

Audituesit ndjekin dhe dokumentojnë me kujdes dhe vlerësojnë statusin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna dhe aktivitetin e subjekteve të audituara në ndjekjen e planit të veprimit të hartuar në lidhje me zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Në përfundim të procesit të verifikimit të rekomandimeve në terren, për auditimet tematike të zbatimit të rekomandimeve, grupi i auditimit harton projekt-raportin e auditimit për secilin subjekt të audituar, sipas Aneksit 3 bashkëngjitur këtij Manuali.

Hartimi i Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Zbatimit të Rekomandimeve, **ndjek afatet** e parashikuara në Rregulloren e Procedurave të Auditimit. Në përfundim të auditimit në terren hartohen:

1. Projekt Raporti i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve.
2. Raporti Përfundimtar i auditimit të zbatimit të rekomandimeve, shoqëruar me statistikat për auditimet e zbatimit të rekomandimeve me program të dedikuar – auditime tematike (formati sipas Aneksit 3, bashkëlidhur këtij Manuali), i cili hartohet nga grupet përkatëse të auditimit për secilin departament auditimi.
3. Raporti Përmbledhës i Zbatimit të Rekomandimeve në nivel Institucional, shoqëruar me statistikat (formati sipas Aneksit 4, bashkëlidhur këtij Manuali), i cili hartohet nga sektori i statistikave.
4. Në rastet kur zbatimi i rekomandimeve kryhet në auditimet e rradhës si drejtim i veçantë në programin e auditimit, rezultatet bëhen pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit përkatës dhe pjesë e Raportit Përmbledhës të zbatimit të rekomandimeve në nivel institucional.

4.1 Raporti Përfundimtar i auditimit të zbatimit të rekomandimeve me program të dedikuar

Raporti përfundimtar i auditimit të zbatimit të rekomandimeve me program të dedikuar “Auditim tematik mbi zbatimin e rekomandimeve” dërgohet në subjekte përmes shkresës përcjellëse, pas miratimit me Vendim të Kryetarit KLSH-së. Subjektit/eve iu rikërkohet marrja e masave për realizimin e plotë të rekomandimeve me status, “zbatuar pjesërisht” dhe “pa zbatuar”, duke arsyetuar gjithashtu mbi domosdoshmërinë e marrjes së këtyre masave.

Për çdo rast të konstatimit të mos zbatimit të rekomandimeve të pranuar, në mënyrë të pa justifikuar dhe të pa argumentuar, si dhe në rastet e moszbatimit të dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale, duhet të përcaktohet përgjegjësia individuale e zyrtarëve dhe nëpunësve publikë.

“

Në varësi të rëndësisë së rekomandimit, qëndrimit të subjektit dhe nëse gjykohet se mund të rritet ndjeshmëria dhe përgjegjshmëria publike në realizimin e rekomandimeve të paraqitura, KLSH, bazuar në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, shkronja “k”, përveç rikërkimit për zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara, “ka të drejtë t’u drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës, në rast të moszbatimeve të rekomandimeve të dhëna”.

”

4.2 Raporti i Konsoliduar i Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve në Nivel Institucional

Raporti i Konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara gjatë vitit të mëparshëm do të përgatitet nga struktura përgjegjëse për statistikën.

Kjo strukturë, pasi grumbullon dhe rakordon statistikën e secilit departament, përgatit statistikën në nivel institucioni dhe më pas përgatit Raportin e Konsoliduar të Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve në Nivel Institucional.

Raporti i Konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara gjatë vitit të mëparshëm do të përgatitet brenda muajit Prill dhe Nëntor të çdo viti nga struktura përgjegjëse për statistikën në koordinim me Departamentet e Auditimit sipas Formatit të Raportit në Aneksin 4.

- Raporti i Konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve i cili përgatitet në muajin Prill të vitit aktual “N+1” përmban të dhëna të zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të kryera përgjatë gjashtëmujorit të I (parë) të vitit të mëparshëm (për periudhën janar - qershor të vitit “N”).
- Raporti i Konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve i cili përgatitet në muajin nëntor - dhjetor të vitit aktual “N+1” përmban të dhëna të zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të kryera përgjatë gjithë vitit të mëparshëm (për periudhën Janar-Dhjetor të vitit “N”), duke përfshirë edhe raportet për auditimet e performancës.

Në vijim, pas miratimit të Kryetarit, të Raportit të Konsoliduar të Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve në Nivel Institucional, struktura përgjegjëse për statistikën vijon me procesin e përcjelljes së këtij raporti për Kuvendin e Shqipërisë, dhe Ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Brenda 5 ditëve nga dërgimi i raportit në Kuvend, sektori përgjegjës për statistikën, dërgon për publikim në faqen zyrtare të KLSH-së, Raportin e Zbatimit të Rekomandimeve.

4.3 Plotësimi i Platformës Ndërinstitucionale të Kuvendit

Me dërgimin e Raportit në Kuvend, punonjësi i statistikës, popullon Platformën Ndërinstitucionale të Kuvendit me rekomandimet dhe statusin përkatës.


Me qëllim marrjen e informacionit të vazhdueshëm dhe të përditësuar nga institucionet e pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për rekomandimet e lëna prej tyre dhe statusin e implementimit të këtyre rekomandimeve nga institucionet publike, Kuvendi i Shqipërisë ka krijuar Platformën Elektronike Ndërinstitucionale, e cila përmban informacion të detajuar për rekomandimet.

Për informimin e plotë dhe të përditësuar, sektori i statistikës plotëson në mënyrë të vazhdueshme platformën e Kuvendit të Shqipërisë, me rekomandimet e lëna për subjektet e audituara. Plotësimi i platformës bëhet në koordinim të plotë dhe të vazhdueshëm me departamentet e auditimit, të cilat me mbarimin e auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve plotësojnë regjistrin e rekomandimeve me statusin e rekomandimit.

Platforma e Kuvendit, në fazën që sapo ka përfunduar plotësimi i regjistrit të rekomandimeve, plotësohet për çdo subjekt të audituar me informacionin e mëposhtëm:

- Vendim i Kryetarit të KLSH-së (dokument i skanuar në formatin PDF);
- Çdo rekomandim në formë narrative;
- Afati për zbatimin e rekomandimit;
- Statusi i zbatueshmërisë së rekomandimit

Figura nr._ : Procesi i popullimit të Regjistrimit të Zbatimit të Rekomandimeve





KREU 5

MONITORIMI

5. MONITORIMI DHE PËRMIRËSIMI I VAZHDESHËM

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve është një përgjegjësi e vazhdueshme e institucionit. Statusi i çdo rekomandimi duhet të përcaktohet dhe të monitorohet në baza të rregullta dhe të planifikuara, duke siguruar që subjektet e audituara të mbeten të angazhuara në përmbushjen e masave të rekomanduara dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të proçeseve.

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve është një proces i pandërprerë i bazuar në një qasje të rregullt dhe të strukturuar, ka si objektiv sigurimin që rekomandimet e dhëna gjatë auditimeve të kaluara të zbatohen plotësisht, në përputhje me planet e masave të miratuara. Për të siguruar një ndjekje efikase dhe përmirësim të vazhdueshëm, monitorimi mund të kryhet nëpërmjet skenareve si më poshtë vijon:

1. Në auditimet e radhës, programi i auditimit mund të përfshijë si një pikë të veçantë, verifikimin e rekomandimeve të auditimeve të periudhave të mëparshme, brenda afatit 3-vjeçar. Ky proces do të përfshijë ndjekjen e rekomandimeve me statusin “pa pranuar”, “pazbatuar” dhe “zbatuar pjesërisht”. Kjo qasje siguron që rekomandimet, të cilat janë brenda periudhës 3 – vjeçare, të mbeten në fokus dhe të monitorohen për zbatimin e tyre.
2. Mund të kryhet një auditim tematik i veçantë për të vlerësuar statusin e atyre rekomandimeve, të cilat rezultojnë “të pazbatuara” dhe “zbatuar pjesërisht”, që janë drejt përmbushjes së afatit të tyre 3-vjeçar. Ky auditim do të jetë një mundësi për të thelluar analizën dhe për të identifikuar pengesat e mundshme që kanë ndikuar në vonesën e zbatimit të rekomandimeve.

Duke marrë parasysh natyrën e ndryshueshme të mjedisit ekonomik dhe social, si dhe frekuencën e auditimeve të KLSH-së, afati përfundimtar i deklaramit të statusit të rekomandimeve është përcaktuar të jetë 3 vjet. Ky afat ofron mundësinë e ndjekjes së ndryshimeve dhe sigurimin që rekomandimet të mbeten relevante dhe të aplikueshme për institucionet e audituara.

Në përfundim të afatit 3-vjeçar, në rast se statusi i rekomandimit nuk ka pësuar ndryshime ose rekomandimi nuk është zbatuar ende, KLSH mund t'i drejtohet Kuvendit të Shqipërisë për të përdorur mekanizmat e duhur për të nxitur zbatimin e rekomandimeve të mbetura ende pa zbatuar. Këto rekomandime, në vijim do të regjistrohen në Regjistrin Elektronik me statusin "përcjellë Kuvendit".



KREU 6

KUFIZIME

6. KUFIZIME

Pavarësisht procesit të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të përshkruara në këtë manual, procesi në vetvete mbart disa kufizime, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e saktë të statusit të rekomandimeve “pa zbatuar” dhe “pjesërisht zbatuar”, dhe që duhen mbajtur në konsideratë në vijim:

- Ndryshe nga auditimet financiare ose të përputhshmërisë, auditimet e performancës fokusohen në vlerësimin e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomikitetit të operacioneve ose programeve të një ose më shumë institucioneve publike, pjesë e të njëjtit sistem/proces. Si rezultat, rekomandimet që rrjedhin nga auditimet e performancës shpesh kërkojnë ndryshime të shumëanshme që përfshijnë sisteme, procese ose politika komplekse. Këto auditime nuk fokusohen vetëm në evidentimin e mangësive dhe problematikave të konstatuara, por edhe në analizimin e faktorëve dhe shkaqeve që kanë çuar në krijimin e tyre. Në këtë kuadër, rekomandimet e formuluar synojnë adresimin e problematikave në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive, duke kërkuar, në raste të caktuara, rishikimin e proceseve, përmirësimin e praktikave të menaxhimit ose ndërmarrjen e ndryshimeve me karakter organizativ dhe operacional. Rrjedhimisht, zbatimi i rekomandimeve nga auditimet e performancës kërkon një proces më të ndërlikuar që kërkon kohë dhe që përfshin bashkëpunimin e palëve të interesuara, shpërndarjen e burimeve, rregullimet e politikave dhe ndonjëherë ndryshime legjislative ose organizative. Kjo natyrë e ndërlikuar e adresimit të përmirësimeve sistemike kontribuon në një afat kohor më të zgjatur të zbatimit të rekomandimeve në auditimet e performancës, në krahasim me llojet e tjera të auditimi.
- Auditimet IT, gjithashtu kërkojnë më shumë kohë për tu zbatuar në krahasim me auditimet financiare ose të përputhshmërisë për shkak të kompleksitetit të sistemeve. Zbatimi i këtyre rekomandimeve shpesh kërkon burime të dedikuara, duke përfshirë personelin e kualifikuar dhe financimin. Departamentet e TI-së mund të kenë nevojë të ripërcaktojnë detyrat dhe të ndajnë burime shtesë për të adresuar rekomandimet në mënyrë efektive. Njëkohësisht zbatimi i ndryshimeve në sistemet e TI-së mund të mbart risqe të tilla si: ndërprerja, humbja e të dhënave ose cënueshmëria e sigurisë, kështu që ekipet e TI duhet të vlerësojnë këto risqe dhe të planifikojnë në përputhje me rrethanat për të minimizuar ndikimet e mundshme negative.
- Rekomandime, të cilat me kalimin e kohës, mund të rezultojnë jo relevante/ jo të aplikueshme për shkak të ndryshimeve të diktuar së jashtmi, dhe për pasojë nuk mund të zbatohen më.
- Rekomandime për përmirësime ligjore që, në varësi të rastit, përcillen për shqyrtim pranë institucioneve përkatëse.



7 ANEKSE

**RAPORT AUDITIMI “PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E
MËPARSHËM NË “ _____ ”*.**

Muaji/viti

PËRMBAJTJA

I. QËLLIMI I AUDITIMIT FOLLOW-UP

II. METODOLOGJIA E PËRDORUR

III. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM

IV. PËRMBLEDHJA E REKOMANDIMEVE

V. REKOMANDIMET e Ri-KËRKUARA

**Modeli i Projekt Raportit hartohet njësoj*

II. QËLLIMI I AUDITIMIT TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Qëllimi i auditimit të ndjekjes është të vlerësojë masën në të cilën institucioni ka zbatuar rekomandimet e dhëna në raportin e mëparshëm të auditimit, si dhe të analizojë ndikimin e tyre në përmirësimin e funksionimit të brendshëm dhe shërbimeve publike.

Auditimi synon të përcaktojë nëse veprimet e ndërmarra janë të mjaftueshme, efektive dhe në përputhje me qëllimin e rekomandimeve.

Gjithashtu, ndjekja e rekomandimeve kontribuon në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës në menaxhimin e burimeve publike.

III. METODOLOGJIA E PËRDORUR

Auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve është zhvilluar në përputhje me kërkesat e Manualit të Zbatimit të Rekomandimeve, standardeve ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikave të mira të fushës.

Procesi përfshiu analizën dokumentare të materialeve të dorëzuara nga institucioni i audituar, përfshirë planet e veprimit, raportet e progresit dhe evidencat mbështetëse të zbatimit të rekomandimeve.

Gjithashtu, janë realizuar intervista me personel kyç dhe janë kryer verifikime të drejtpërdrejta në terren, aty ku ishte e nevojshme.

Rekomandimet janë klasifikuar sipas statusit të tyre aktual (zbatuar plotësisht, pjesërisht, pa zbatuar) bazuar në nivelin e evidencave të siguruara dhe vlerësimin e gjykimin profesional të grupit të auditimit.

I. Konkluzioni

I. (Emri i subjektit).....

Nga auditimi i ushtruar në për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “objekti i auditimit” për periudhën ... deri më ... trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr., datë, të Kryetarit të KLSH-së, përcjellë me shkresën nr. prot., datë, rezultoi se:

- Subjekti nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor, në kundërshtim me nenin 15, germa (j), të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit’, si dhe nuk ka respektuar afatin 6-mujor, në kundërshtim me pikën 2, nenin 30, të të njëjtit ligj.

Gjatë auditimit u shqyrtuan __ rekomandime të lëna, nga ku u konstatua se: nga ___ rekomandime, janë pranuarmasa ose ..%, ndërsa ... masa ose rreth ...% e tyre nuk janë pranuar.

Nga masat e rekomanduara dhe të pranuara, janë zbatuar plotësisht ... masa ose ... %; zbatuar pjesërisht ... masa ose .. % dhe janë të pazbatuara ... masa të rekomanduara ose ...% e tyre.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

-..rekomandime për përmirësime/ndryshime legjislacioni, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar.

- rekomandime masa organizative, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar.

- ...rekomandime masa shpërblim dëmi në vlerën mijë lekë, pranuar nga subjektet masa me vlerë ,,,,,mijë lekë, nga të cilatmasë në vlerënmijë lekë janë zbatuar, ... masa në vlerënmijë lekë janë zbatuar pjesërisht dhe masa në vlerënmijë lekë nuk janë zbatuar.

-.... rekomandime masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike në vlerë....mijë lekë, pranuar nga subjektet masa me vlerë ,,,,,mijë lekë; , nga të cilatmasë në vlerënmijë lekë janë zbatuar,.... masa në vlerënmijë lekë janë zbatuar pjesërisht dhe masa në vlerënmijë lekë nuk janë zbatuar.

- rekomandime masa disiplinore, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar.

- ... rekomandime masa administrative, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar.

Për sa më sipër, (emri i subjektit), për të gjitha rekomandimet që kanë rezultuar me status të “zbatuar pjesërisht” dhe “pa zbatuar”, KLSH rikërkon zbatimin e plotë të tyre si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACION

1. Gjetje nga auditimi:

1.1 Rekomandimi:

Qëndrimi i grupit të auditimit.....

Statusi i rekomandimit:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

1.1 Rekomandimi:

Qëndrimi i grupit të auditimit.....

Statusi i rekomandimit:

C.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

1.1 Rekomandimi:

Qëndrimi i grupit të auditimit.....

Statusi i rekomandimit:

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi:

1.1 Rekomandimi:

Qëndrimi i grupit të auditimit.....

Statusi i rekomandimit:

E. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi:

1.1 Rekomandimi:

Qëndrimi i grupit të auditimit.....

Statusi i rekomandimit:

F. MASA DISIPLINORE

1. Gjetje nga auditimi:

1.1 Rekomandimi:

Qëndrimi i grupit të auditimit.....

Statusi i rekomandimit:

G. MASA ADMINISTRATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

1.1 Rekomandimi:

Qëndrimi i grupit të auditimit.....

Statusi i rekomandimit:

V. REKOMANDIMET E RI-KËRKUARA

Për të gjitha rekomandimet që rezultuan me status “*të pazbatuara*” dhe “zbatuar pjesërisht”, rikërkohet të merren masa të nevojshme me qëllim zbatimin e plotë të tyre;

Në mbështetje të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve tona, të raportohet me shkrim pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Në vijim, paraqiten rekomandimet me status “pa zbatuar” dhe “zbatuar pjesërisht”

A. Rekomandime me status “pa zbatuar”*

1. Rekomandim/afati i zbatimit
2. Rekomandim/afati i zbatimit

B. Rekomandime me status “zbatuar pjesërisht”

1. Rekomandim/afati i zbatimit
2. Rekomandim/afati i zbatimit

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

Grupi i Auditimit

DREJTORI I DEPARTAMENTIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti

.....

Nr..... / __ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .202

PROJEKT

V E N D I M

Nr. __, Datë __/__/202

PËR

AUDITIMIN e USHTRUAR NË ...SUBJEKTE, emri i subjekteve “MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET”.

Nga auditimi i ushtruar mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve, sipas programit të auditimit me nr. ... prot, datë, me objekt “.....”, si dhe në përputhje me kërkesat e Manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistri elektronik institucional”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr....., datë, u konstatua se, janë dhënë gjithsejrekomandime, janë pranuarmasa ose ..%, si dhe nuk janë pranuar ... masa ose rreth % e tyre. Nga masat e rekomanduara dhe të pranuar, janë zbatuar plotësisht ... masa ose ... %; zbatuar pjesërisht ... masa ose .. % dhe janë të pazbatuara ... masa të rekomanduara ose ...% e tyre.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të mësipërm, Departamenti i Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në” sipas programit të auditimit nr. prot, datë, për veprimtarinë nga data ... deri më, përsubjekte si vijon:

- 1.
- 2.

II. Të miratoj konkluzionin e auditimit, rekomandimet e përcaktuara dhe të ri-kërkoj marrjen e masave për zbatimin tyre, si dhe;

- Për të gjitha rekomandimet që kanë rezultuar me status “zbatuar pjesërisht” dhe “pa zbatuar” nga KLSH rikërkohet zbatimi i plotë i tyre dhe në mbështetje të nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve tona, të raportohet me shkrim pranë KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të tyre.

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet.....” mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet e INTOSAI-t, Manualët e Auditimit të KLSH-së, për periudhën deri mërezultoi se, niveli i zbatimit të rekomandimeve në (në nr) institucionet e sipër përmendura, paraqitet si vijon:

a. Lidhur me detyrimin ligjor të subjekteve të audituara për të informuar KLSH rreth hartimit të programit të tyre për të zbatuar rekomandimet e lëna, brenda afatit 20-ditor ka rezultuar se:

- ... subjekte (.....) kanë respektuar afatin 20-ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15, shkronja “j” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- ... subjekt (...) nuk kanë respektuar afatin prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 15 shkronja “j” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

b. Lidhur me detyrimin ligjor të subjekteve të audituara për të raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna brenda afatit 6 mujor ka rezultuar si më poshtë:

-subjekte (.....) kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- subjekte (.....) nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në kundërshtim me përcaktimet e pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në (.....) subjektet e audituara janë dhënë gjithsejrekomandime, janë pranuarmasa ose ..%, si dhe nuk janë pranuar ... masa ose rreth % e tyre. Nga masat e rekomanduara dhe të pranuar, janë zbatuar plotësisht ... masa ose ... %; zbatuar pjesërisht ... masa ose .. % dhe janë të pazbatuara ... masa të rekomanduara ose ...% e tyre.

Niveli i zbatimit të **rekomandimeve** sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

.....**rekomandime për përmirësim/ndryshime legjislativ**, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar

- **rekomandime masa organizative**, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht, dhe masa nuk janë zbatuar.

- ...**rekomandime masa shpërblyerje në vlerën mijë lekë**, pranuar nga subjektet masa me vlerë,mijë lekë, nga të cilatmasë në vlerënmijë lekë janë zbatuar, masa në vlerënmijë lekë janë zbatuar pjesërisht dhe masa në vlerënmijë lekë nuk janë zbatuar.

- **rekomandime masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike të ardhurat e munguara në vlerë....mijë lekë**, pranuar nga subjektet masa me vlerë,mijë lekë; , nga të cilatmasë në vlerënmijë lekë janë zbatuar, masa në vlerënmijë lekë janë zbatuar pjesërisht dhe masa në vlerënmijë lekë nuk janë zbatuar.

- **rekomandime masa disiplinore**, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar.

- ... **rekomandime masa administrative**, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar.

Detajuar sipas subjekteve të audituara si më poshtë vijon:

I. EMRI I SUBJEKTIT

Nga auditimi i ushtruar në për zbatimin e rekomandimeve të KLSH “objekti i auditimit” për periudhën deri më trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr., datë, të Kryetarit të KLSH-së, përcjellë me shkresën nr. prot., datë, rezultoi se:

- Subjekti nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor, në kundërshtim me nenin 15, germa (j), të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit’, si dhe nuk ka respektuar afatin 6-mujor, në kundërshtim me pikën 2, nenin 30, të të njëjtit ligj.

Gjatë auditimit u shqyrtuan ___ rekomandime të lëna, nga ku u konstatua se: nga ___ rekomandime, janë pranuarmasa ose ..%, ndërsa ... masa ose rreth ...% e tyre nuk janë pranuar.

Nga masat e rekomanduara dhe të pranuara, janë zbatuar plotësisht ... masa ose ... %; zbatuar pjesërisht ... masa ose .. % dhe janë të pazbatuara ... masa të rekomanduara ose ...% e tyre.

Niveli i zbatimit të **rekomandimeve** sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

-..rekomandime për përmirësime/ndryshime legjislativ, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar.

- rekomandime masa organizative, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar.

- ...rekomandime masa shpërblim dëmi në vlerën mijë lekë, pranuar nga subjektet masa me vlerë,mijë lekë, nga të cilatmasë në vlerënmijë lekë janë zbatuar, masa në vlerënmijë lekë janë zbatuar pjesërisht dhe masa në vlerënmijë lekë nuk janë zbatuar.

-.... rekomandime masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike të ardhurat e munguara në vlerë....mijë lekë, pranuar nga subjektet masa me vlerë,mijë lekë; nga të cilatmasë në vlerënmijë lekë janë zbatuar, masa në vlerënmijë lekë janë zbatuar pjesërisht dhe masa në vlerënmijë lekë nuk janë zbatuar.

- rekomandime masa disiplinore, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar.

- ... rekomandime masa administrative, pranuar nga subjektet masa, nga të cilatmasa janë zbatuar, ... masa janë zbatuar pjesërisht dhe masa nuk janë zbatuar.

Për sa më sipër, ri kërkojmë që, (emri i subjektit) të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të “zbatuara pjesërisht” dhe “të pazbatuara” si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACION

B. MASA ORGANIZATIVE

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

E. TË ARDHURA TË MUNGUARA

F. MASA DISIPLINORE

G. MASA ADMINISTRATIVE

Të gjitha rekomandimet së bashku me Raportet Përfundimtare respektive, do tu përcillen(.....)
subjekteve, respektivisht:

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim
ngarkohet Departamenti i*


GRUPI I AUDITIMIT

.


K R Y E T A R

Arben Shehu

ANEKS 1.1 : Sqarim mbi plotësimin e evidencës statistikore të pranimit të rekomandimeve



ANEKS 1.2 : Sqarim mbi plotësimin e evidencës statistikore te zbatimit të rekomandimeve




Shënim:

(ii) Opsioni “Nuk është përmbushur afati 6 mujor i kthimit të përgjigjes” është vetëm për periudhët 4 mujore, për efekt të përgatitjes së Buletinit Statistikor

(iii) Nëse rekomandimi është me status “i papranuar”, edhe tek zbatueshmëria do të raportohet “i papranuar”

ANEKS 2: Regjistri i zbatimit të rekomandimeve për vitin paraardhës - shembull
Plotësohet nga sektori përgjegjës për statistikat

Lloji i auditimit	Filluar auditimi ne vitin:	Emërtimi i subjektit ose temës	Muaji i evadimit	Lloji i institucionit ku ushtrohet auditimi	Lloji i rekomandimit	Rekomandimi (sipas Vendimit të Kryetarit)	Afati për zbatim	Me program të veçantë ose drejtim auditimi	Kthyer përgjigje 20 ditore	Pranueshmëria 20 ditore per KLSH	Kthyer përgjigje 6 mujore	Pranueshmëria 6 mujore	Pranueshmëria ne terren	Zbatueshmëria per KLSH
Përputhshmërie	2024	Subjekti 1	Prill 2025	Institucione të qeverisjes qendrore dhe të vartësisë	Mase organizative		Menjëherë dhe në vijimësi	Me program të veçantë	Kthyer përgjigje 20 ditore	Po	Nuk ka kthyer përgjigje 6 mujore	Pa përgjigje	Pranuar	Pa zbatuar
Përputhshmërie	2025	Subjekti 2	Prill 2025	Institucione të qeverisjes qendrore dhe të vartësisë	Permiresim Ligjor		Brenda vitit 2025	Me program të veçantë	Kthyer përgjigje 20 ditore	Po	Nuk ka kthyer përgjigje 6 mujore	Pa përgjigje	Pranuar	Zbatuar pjesërisht



ANEKS 3: Evidencat e zbatimit të rekomandimeve
Plotësohen nga grupet e auditimit përkatëse

Evidenca nr. 1

Nr	Subjekt/ tema	Subjektet e audituara nga dep.perfor mances	Lloji i auditimit	Departa menti i auditimit	Lloji i masës	Vlera për efektet financia re në mijë lekë	Rekoman dimi (përshkri mi i plotë sipas Vendimit të Kryetarit)	Afati i kerkuar	Pranues hmeria 20 ditore	Pranues hmëria ne terren	Zbatues hmëria	Rekoman dimi i rikerkuar	Afati i rikerkuar

P/grupi

Specialisti/Sektori i Statistikës

Shënim:
* Evidenca është ndërtuar mbi “drop down list” në excel, e cila na mundeson perzgjedhjen nga lista
* Rekomandimi te vendoset i plotë sikundër në Vendim
* Vlerat e efekteve financiare do të jenë në mijë lekë
*Evidenca do të dërgohet ne versionin excel nga sektori i Statistikës

Evidenca nr. 2.2


NR	Emërtimi i subjektit dhe lloji i rekomandimeve	Rekomanduar	Pranuar plotësisht	Nga të pranuarat				Pa pranuar
				Pranuar Pjesërisht	Zbatuar	Pjesërisht	Pa zbatuar	
1	Subjekti 1							
	Nga këto;							
	<i>Propozime për ndryshim legjislacioni</i>							
	<i>Masa Organizative</i>							
	<i>Masa Zhdëmtimi (numër)</i>							
	<i>000/Lekë</i>							
	<i>Masa 3E (numër)</i>							
	<i>000/Lekë</i>							
	<i>Masa Administrative</i>							
	<i>Masa Disiplinore</i>							
2	Subjekti 2							
	Nga këto;							
	<i>Propozime për ndryshim legjislacioni</i>							
	<i>Masa Organizative</i>							
	<i>Masa Zhdëmtimi (numër)</i>							
	<i>000/Lekë</i>							
	<i>Masa 3E (numër)</i>							
	<i>000/Lekë</i>							
	<i>Masa Administrative</i>							
	<i>Masa Disiplinore</i>							

P/grupi

Specialisti/Sektori i Statistikës

Shenim:
 Plotësohet nga grupet e auditimit
 Firmoset nga p/grupi
 Konfirmohet nga Sektori i Statistikës

ANEXS 3: Raporti i konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve në nivel institucional
plotësohet nga Sektori i Statistikave



Nr Përmbajtja

Faqe

1. Hyrje
2. Përmbledhja e Rezultateve
3. Kufizime
4. Rezultatet e auditimit të zbatimit të rekomandimeve sipas subjekteve
4. Aneksë
 - 4.1 Lista e subjekteve /temave të përfshirë në Raport
 - 4.2 Zbatueshmëria e rekomandimeve sipas llojit
 - 4.3 Zbatueshmëria e rekomandimeve “përmirësime ligjore” sipas subjekteve/temave
 - 4.4 Zbatueshmëria e rekomandimeve “masa organizative” sipas subjekteve/temave
 - 4.5 Zbatueshmëria e rekomandimeve “masa disiplinore” sipas subjekteve/temave
 - 4.6 Zbatueshmëria e rekomandimeve “masa administrative” sipas subjekteve/temave
 - 4.7 Zbatueshmëria e rekomandimeve “shpërblim dëmi” dhe “të ardhura të munguara” sipas subjekteve/temave
 - 4.8 Zbatueshmëria e rekomandimeve “për eliminimin e efekteve negative” sipas subjekteve/temave

